



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2020

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z. Agim Bahtiri, Kryetar i Komunës
Adresa: Rr. "Bedri Gjinaj", Mitrovicë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Gjatë vitit 2020, Komuna kishte paguar 178,688€ shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.

C1 Pagesat në vlerë 86,993€ ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 630,508€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin realizuar pagesa në vlerë 185,054€ (prej tyre 142,642€ ishin me vendim gjyqësor) për shpenzime të cilat për nga natyra dhe sipas planit kontabël i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime; dhe
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin realizuar pagesa në vlerë 445,453€, prej tyre 20,420€ (ishin bazuar në vendimet gjyqësore) për shpenzime të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë investime kapitale, si dhe 425,033€ ishin pagesa direkte nga thesari bazuar në vendimet gjyqësor për pagat jubilarë.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Shpenzimet e larta për procedurat përmbartimore

Gjetja Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPF, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Vlera e pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendime gjyqësore/përmbartimore ishte 1,746,868€, prej tyre borxhi kryesor ishte 1,568,180€ ndërsa 178,688€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit. Pagesat kishin të bënin me paga jubilarë, pagesa për shërbime, investime, etj.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Komuna në mungesë të mjeteve buxhetore nuk kishte realizuar pagesat brenda afatit kohorë ligjorë.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve ndikon që këto pagesa të realizohen përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore, e të cilat kanë edhe shpenzime tjera shtesë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në pesë raste pagesat në vlerë 86,993€ ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga 55 deri në 174 ditë.

Kjo gjendje ishte si shkak i menaxhimit jo të mirë të obligimeve nga ana e komunës, ku komuna ka vazhduar të hy në obligime të reja pa shlyer obligimet paraprake.

Ndikimi Vonesat e pagesave ndaj furnitorëve, ndikojnë që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraparak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari që njëkohësisht reflektohet me kosto shtesë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Komuna gjatë vitit 2020 kishte realizuar të hyra në vlerë 1,766,659€. Këto të hyra janë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, veprimtaritë biznesore, qiraja etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga policia, gjykata dhe agjencia e pylltarisë) në vlerë prej 242,770€.

Çështja B1 - Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira

Gjetja

Sipas Ligjit 06/L-092 prona e paluajtshme e komunës mund të jepet në shfrytëzim për të gjithë personat fizik dhe juridik me një afat të caktuar. Sipas kushteve të kontratave, pagesa e obligimit duhet të bëhet deri me datën 05 të çdo muaji vijues. Në kontrata specifikohet se Kuvendi Komunal çdo 2 vjet, do të bëjë rivlerësimin e gjendjes ekonomike të familjeve, me qëllim të vazhdimit/ndërprerjes së vlefshmërisë së kontratës. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Nga testimi i listave të shfrytëzuesve të pronës publike (dhënien e lokaleve afariste me qira, dhënien e banesave për familjet e dëshmorëve, rastet sociale dhe për kuadro) dhe dhënien e tokës për ndërtim biznesi, ne kemi vërejtur si në vijim:

- Kuvendi Komunal përmes ankandit kishte dhënë në shfrytëzim tokë komunale me dt.10.11.2010 për periudhën 10 vjeçare. Kontrata ka skaduar dhe komuna nuk kishte iniciuar ndonjë proces për vazhdimin/ndërprerjen e saj. Qiraja mujore ishte me vlerë 679€ e cila vlerë nuk ishte faturuar dhe arkëtuar në dhjetor 2020. Sipas komunës për shkak të investimeve të shfrytëzuesit aktual ende nuk kanë marrë ndonjë vendim lidhur me shfrytëzuesin e tokës;
- Për dy lokale të dhëna me qira kontratat kishin skaduar me 05.01.2020 dhe nuk janë vazhduar. Kjo për shkak se priten procedura të ankandit derisa qiramarrësit vazhdojnë të shfrytëzojnë ato pa kontrata, me arsyetimin e komunës për mos dëmtim të biznesit;
- Në komplekset banesore të dhëna me qira për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale në total 36 banesa, komuna nuk kishte bërë verifikimin e gjendjes ekonomike të shfrytëzuesve të banesave ashtu siç parashihej me kontratë, derisa të njëjtit qiramarrës vazhdojnë të shfrytëzojnë ato; dhe
- Për 13 banesat e dhëna me qira për fondin për kuadro, kontratat kishin skaduar në vitin 2016 dhe nuk janë vazhduar më, pasi që në koordinim me MMPH banesat duhet të trajtohen sipas Ligjit të programeve të veçanta të banimit. Qiramarrësit vazhdojnë t'i shfrytëzojnë ato. Komuna nuk arkëton të hyra dhe nuk i faturon qiramarrësit. Të njëjtit kishin paditur komunën lidhur me ligjshmërinë e kontratave.

- Ndikimi** Vazhdimi i praktikave të tilla mund të nxisin edhe obliguesit tjerë t'i shmangen pagesës së obligimeve. Mos arkëtimi i qirave nga dhënia në shfrytëzim e pronave, komunës i shkakton humbje buxhetore dhe rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake, apo edhe projekteve të reja në dobi të qytetarit.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pronat e shfrytëzuara nga personat privat apo juridik të rikthehen nën kontroll të komunës, ose të bëhet ripërtërija e kontratave në mënyrë që komuna të arkëtojë të hyra nga dhënia në shfrytëzim e pronave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 4,098,120€, prej tyre ishin shpenzuar 3,338,650€. Këto shpenzime ishin kryesisht për mirëmbajtjen e hapësirave, ndërtesave, rrugëve, shpenzime për derivate, shërbime kontraktuese, furnizime mjekësore, etj.

Çështja A2 - Mos azhurnim i planit të menaxhimit të kontratave

Gjetja

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ i prokurimit publik, pika 61 – Menaxhimi i kontratës, dhe pikat 61.7 dhe 61.20 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës (MK) në menaxhimin e kontratave publike. Menaxheri i kontratës duhet të sigurojnë se Kontrata po realizohet në përputhje me kushtet kontraktuale. Po ashtu në pjesën III të kontratës tek pika 22.1 theksohen specifikat e mallit që duhet të plotësohen. Sipas formularit standard të planit të menaxhimit të kontratave specifikohet se plani i menaxhimit të kontratës është dokument i gjallë i cili përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punimeve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale.

Te kontrata “Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse dru për ngrohje dhe Institucione tjera komunale” – me vlerë 229,950€ e lidhur me dt.06.10.2020, menaxheri i kontratës nuk kishte arritur të sigurojë dëshmi për cilësinë e mallrave të pranuar, e të cilat sipas kontratës duhej të inspektoheshin lidhur me lagështinë 12% dhe m3. Po ashtu, në tri pagesa të testuara me vlerë 19,011€ nuk është dokumentuar as dëshmia për prejardhjen e druve nga Agjencia Pyjor ose DUD-in doganor. Dëshmia e prejardhjes së druve sipas specifikimeve teknike në dosjen e tenderit është dashur të ofrohet së bashku me faturën e OE.

Vlen të theksohet se, kjo është kontratë kornizë vetëm gjatë vitit të parë, (tetor, nëntor, dhjetor- 2020) ishin shpenzuar 116,588€ apo 50% e totalit të kontratës të parashikuar për tri vjet, kjo do të duhej të ishte raportuar tek plani i menaxhimit të kontratës.

Po ashtu, për dy kontratat “Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse dru për ngrohje dhe Institucione tjera komunale” me vlerë 229,950€, dhe “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të komunës dhe institucioneve tjera komunale” me vlerë 150,000€ e lidhur me datën 17.07.2020, ishin përgatitur planet e menaxhimit por të njëjtat nuk ishin azhurnuar asnjëherë, për më tepër menaxherët nuk mbanin shënime për shpenzimet dhe mbarëvajtjen e kontratës.

Menaxherët e kontratave nuk ishin në dijeni se janë të obliguar që të përcjellin dhe të dokumentojnë në vazhdimësi realizimin e kontratave në planet e menaxhimit të kontratave.

Ndikimi

Menaxhimi dhe monitorimi i dobët i kontratave mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale. Mungesa e njohurive lidhur me përgjegjësit të cilat i kanë menaxherët e kontratave ndikon direkt në realizimin sipas planit të kontratave përkatëse.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth zbatimit të kontratave, si dhe për progresin në zbatimin e kontratave të raportohet tek kryetari dhe tek zyra e prokurimit në baza të rregullta kohore një apo tre mujore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Sigurimi i ekzekutimit të kontratës jo i plotë**

Gjetja Sipas LPP-së, neni 63 -siguria e ekzekutimit pika 1, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë një kontratë që të depozitohet një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës. Sipas pikës 3 të këtij neni Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shumica e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi 1. i këtij neni: (i) të jetë e barabartë me së paku dhjetë përqind (10%) të vlerës së kontratës. Ky kriter ishte kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Për kontratën “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me vlerë prej 150,000€, vlera e sigurimit të ekzekutimit të kontratës do të duhej të ishte 15,000€, OE kishte ofruar sigurinë e ekzekutimit në vlerë 5,000€.

Sipas komunës pagesa e pjeshme për sigurinë e ekzekutimit është aplikuar për shkak të neglizhencës së zyrtarëve kompetent.

Ndikimi Sigurimi i ekzekutimit të kontratës i pjesshëm rrezikon që komuna të mos ketë mbulueshmëri nëse kontraktuesi dështon në realizimin e punëve, të cilat mund të shkaktojnë dëme substanciale ose shpenzime të shtesë për mbylljen e kontratës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë e ekzekutimit para lidhjes së kontratës, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e obligimeve kontraktuale nga ana e operatorëve ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,527,739€, prej tyre ishin shpenzuar 4,576,821€. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale, pajisjeve etj. Kemi testuar 32 mostra për teste substanciale në vlerë 2,240,153€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mungesa e garancionit për punët e realizuara/përfunduara

Gjetja Tek kushtet e përgjithshme të kontratës, përkatësisht neni 34.5 përcaktohet se periudha garantuese e defekteve është një vit.

Në pesë projekte kapitale të cilat kishin përfunduara në vitin 2020, dhe për të cilat ishin bërë pranimet teknike komuna nuk kishte kërkuar nga OE garancionin e punimeve të ekzekutuara.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Në rast të defekteve të cilat mund të shfaqen pas pranimi të punëve nga faktorë të ndryshëm, në mungesë të garancionit për punët e realizuara OE nuk obligohet që t'i riparoj apo zëvendësoj ato. Në këtë rast komunës do ti shkaktoj shpenzime tjera/shtesë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen në tërësi të gjitha kushtet e vendosura në kontratë, duke aplikuar edhe deklaratën e nënshkruar nga OE për garancionin e punimeve të ekzekutuara/realizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit

Gjetja Sipas LPP-së Neni 9, pika 3 - Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale. ZKF do të siguroj që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore, ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Lidhur me këtë, ne kemi identifikuar se:

- Projekti “Renovimi i nyjeve sanitare në ndërtesën e Komunës” – vlera e parashikuar për vitin 2020 ishte 20,000€ ndërsa kontrata një vjeçare ishte nënshkruar me dt.30.09.2020 në vlerë 33,313€ apo 13,313€ më e lartë se vlera e planifikuar;
- Projekti “Ndërtimi i objektit shëndetësor- Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Kushtovë”- vlera e parashikuar dhe e buxhetuar për dy vite (2020 dhe 2021) ishte 125,000€ ndërsa kontrata ishte nënshkruar me dt.07.12.2020 në vlerë 194,332€, apo 69,332€ më e lartë se vlera e planifikuar.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe futja e tyre në ligj të buxhetit, pa ndonjë analizë paraprake të mirëfilltë të projekteve.

Ndikimi

Hyrja në obligime kontraktuale nga komuna përtej mundësive buxhetore dhe në kundërshtim me ligjin, ndikon dhe rrezikon mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve sipas planifikimeve si dhe krijon kosto shtesë për komunën, duke e futur komunën në vështirësi në përmbushjen e obligimeve të krijuara.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A5 - Vonesë në njoftimin për nënshkrim të kontratës

Gjetja

Neni 41/A të LPP-së -Njoftimi për nënshkrimin e kontratës - përcakton: “Nëse autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotimit të çmimeve, ose procedurat me vlera minimale, Autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës.

Komuna e Mitrovicës, në tetë (8) aktivitete të prokurimit publik, njoftimet për nënshkrim të kontratë i kishte bërë me vonesë. Vonesat variojnë nga 4 deri në 112 ditë kalendarike.

Sipas komunës kjo kishte ndodhur për shkak se komuna kishte punuar me staf të reduktuar dhe nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme publikimit të këtij njoftimi.

Ndikimi

Vonesat për njoftimin për nënshkrimin e kontratës, cenon transparencën ndaj Operatorëve Ekonomik dhe KRPP-së të cilët duhet të kenë informata të sakta lidhur me furnizimet apo shërbimet që i nevojiten AK-ve.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 32,488,094€, pasurive jokapitale është 672,598€, si dhe e stoqeve 15,589€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 4,492,266€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Mos-mbyllja e kategorisë së investimeve në vijim pas pranimit të pasurisë

Gjetja Neni 12 paragrafi 2 dhe 3 të Rreg. nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, përcakton se: “Deri në momentin e pranimit të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese do të regjistrojnë transaksion në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkë financuese.”

Projekti për “Ndërtimin e kopshtit Botanika” në vlerë 209,575€ kishte përfunduar gjatë vitit 2020 dhe ishte bërë pranimi teknik. Megjithatë, ende vazhdon të mbahet e regjistruar si investim në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos koordinimit ndërmjet zyrtares së pasurisë dhe njësive tjera për tu informuar lidhur me projektet e përfunduara.

Ndikimi Mungesa e informatave të plota dhe të sakta lidhur me pasurinë në dispozicion të komunës ndikon në menaxhim jo të mirë të pasurive dhe prezantim jo të drejtë në PVF.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin e regjistrimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Parregullsi në menaxhimin dhe shpalosjen e pasurive në PFV

Gjetja Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, te neni 6, citon që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri. Më tutje, neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve.

Lidhur me menaxhimin e pasurisë kemi trajtuar këto çështje si në vijim:

Vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte mbivlerësuar për 28,278€, kjo

vlerë i takon taksave të përmbaresve, si dhe është nënvlerësuar për 9,648€ pasuri e cila nuk është regjistruar fare në regjistra.

Ndërsa vlera e pasurive nën 1,000€ ishte mbivlerësuar për 7,407€ të cilat ishin pasuri kapitale mbi 1,000€. Poashtu vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë, ajo është mbivlerësuar sepse nuk është bërë zhvlerësimi i saj.

Sipas zyrtarëve përgjegjës të komunës kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të modulit të zhvlerësimit në sistemin e-pasuria gjatë vitit 2020 dhe kontrolleve jo të mira me rastin e regjistrimit të pasurisë.

Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PFV. Raporti për inventarizimin e pasurisë së komunës është përfunduar me 04.02.2020. Rrjedhimisht, asnjë rezultat i inventarizimit nuk është reflektuar në PFV.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni i inventarizimit nuk i ka kryer detyrat në pajtim me vendimin për caktimin e komisionit dhe nuk janë zbatuar dispozitat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Më tutje, Komuna kishte arritur që të bëjë verifikimin e pronave komunale, mirëpo edhe më tutje nuk kishte arritur të bëjë vlerësimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në regjistrat e SIMFK-së (tokat dhe objektet), kjo ka qenë e planifikuar të bëhet gjatë vitit 2020 nga bashkëfinancimi, mirëpo për shkak të situatës pandemike vlerësimi nuk është bërë.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar në menaxhimin e pasurisë që kanë të bëjnë me mos regjistrimin e pasurive kapitale dhe mos përdorimin e sistemit E-pasuria si dhe procesit të inventarizimit, ndikojnë në raportimin e informatave jo të sakta për pasurinë e komunës dhe vlerën e tyre në PFV. Njëherit, rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre.

Rekomandimi B3

Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 11,503,432€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 6,765,214€, taksat dhe tarifat komunale 1,888,023€ dhe pjesa tjetër përbëhet nga pagesat për mbeturina për ekonomi familjare, dhënia në shfrytëzim e pronave lokale etj.

Çështja B4 - Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Komuna nuk po arrin të krijoj mekanizma për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Krahasuar me vitin paraprak 2019, LLA janë rritur për 2,556,606€ apo rreth 22%. Sfida kryesor mbetet inkasimi i tatimit në pronë në vlerë prej 6,765,214€, të hyrat nga tarifat komunale në vlerë 188,023€ dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 1,281,379€.

Komuna kishte bërë përpjekje që të ketë një arkëtim më të mirë nga tatimpaguesit e tatimit në pronë, përmes një vendimi të mëhershëm të kryetarit. Të gjithë tatimpaguesit ishin të obliguar të paguajnë një % të caktuar për borxhet e mbetura, megjithatë kjo nuk ishte reflektuar në pagesën e borxheve nga tatimpaguesit.

Në vitin 2020 për shkak të pandemisë nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Shpalosje jo e saktë e llogarisë së arkëtueshme

Gjetja

Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Bazuar në PFV dhe shënimeve për të arkëtueshmet të pranuar nga komuna ne kemi vërejtur se:

Në PVF llogaritë e arkëtueshme të prezantuara nga zyra për menaxhimin e tatimit në pronë ishin mbivlerësuar për 91,448,96€. Derisa edhe llogaritë e

arkëtueshme nga taksat në biznes ishin nënvlerësuar, pasi që softueri me të cilin menaxhohen këto llogari nuk ishte funksional në vitin 2020 dhe për këtë nuk ishin faturuar fare bizneset.

Për këto diferenca komuna ishte në dijeni megjithatë, nuk kishte arritur të paraqesë saktë ato meqë Departamenti i tatimit në pronë nuk kishte mundur të iu ofrojë ndihmë si dhe softueri me të cilin menaxhonte komuna taxat në biznes ishte jashtë përdorimit. Sipas komunës bizneset do të faturohen në vitin 2021 edhe për vitin 2020.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar në shpalosjet e llogarive të arkëtueshme, ndikojnë në shpalosjen apo prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV.

Rekomandimi C2

Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhet prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit-Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Komuna në muajin tetor 2020 ka themeluar komitetin e auditimit i cili është funksional dhe kishte mbajtur tri takime. NjAB përveç planit strategjik kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2020 dhe deri në fund të vitit kishte finalizuar gjashtë raporte të Auditimit, aq sa ishin planifikuar. Lidhur me funksionimin e NJAB-së, kemi trajtuar çështjen si në vijim:

Çështja A7 - Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm

Gjetja Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Ne kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB dhe kemi vërejtur një zbatim të ultë të rekomandimeve. Nga 34 rekomandime të dhëna, 11 ishin zbatuar ndërsa 8 ishin në proces dhe 15 rekomandime nuk ishin zbatuar.

Shkaku i mos zbatimit të rekomandimeve është mungesa e një procesi formal të monitorimit të tyre nga menaxhmenti.

Ndikimi Mungesa e gatishmërisë për të zbatuar plotësisht rekomandimet e NJAB-së ndikon në mos përmirësimin e proceseve të cilat më pas ndikojnë në mos arritjen e objektivave të Komunës.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,115,359	23,393,842	21,203,738	19,555,066	19,067,588
Grante Qeveritare – Buxheti	19,615,384	19,761,445	18,874,382	16,950,914	16,627,843
Financimi përmes huamarrjes	0	134,912	115,801	52,878	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	468,001	441,740	347,061	317,997
Të hyrat vetanake	2,499,975	2,499,975	1,316,604	2,116,286	1,927,625
Donacionet vendore	0	109,915	49,084	16,464	79,767
Donacionet e jashtme	0	419,594	406,127	71,463	114,356

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,278,480€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së grantit qeveritar, donacioneve vendore dhe të jashtme si dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 21,203,738€, me një ulje prej 5% krahasuar me vitin 2019. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,115,359	23,393,842	21,203,738	19,555,066	19,067,588
Pagat dhe mëditjet	12,165,604	12,249,891	12,187,045	11,885,268	11,906,445
Mallrat dhe shërbimet	2,668,883	4,098,120	3,338,650	2,072,726	2,351,120
Komunalitë	493,815	481,484	382,851	482,100	460,597
Subvencionet dhe transferet	530,043	1,036,608	718,371	531,282	723,730
Investimet Kapitale	4,501,683	5,351,685	4,576,821	4,583,690	3,625,696
Rezervat	1,755,331	176,054	0	0	0


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 84,286€ si rezultat i financimit përmes huamarrjes dhe donacioneve.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,416,906€, si rezultat i transfereve dhe rialokimeve buxhetore ndërmjet kategorive, si dhe sipas vendimit të Qeverisë Nr.01/23 të dt. 13.08.2020;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 506,565€, si rezultat i shpërndarjes së rezervave shtetërore, donacioneve, të hyrave vetanake, si dhe sipas vendimit të Qeverisë Nr.01/23 të dt. 13.08.2020;
- Buxheti final për shpenzimeve kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 850,002€, si rezultat i shpërndarjes së rezervave shtetërore, financimit përmes huamarrjes, donacioneve të brendshme dhe jashtme, si dhe me vendim të Qeverisë Nr.01/23 të dt. 13.08.2020;
- Rezervat në krahasim me buxhetin fillestar ishin zvogëluar për 1,579,278€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore.


Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19:

Komuna e Mitrovicës së Jugut për menaxhimin e pandemisë Covid 19 kishte shpenzuar 682,158€, prej tyre për shtesa në paga dhe mëditje ishin shpenzuar 381,045€, mallra dhe shërbime ishin shpenzuar 261,427€ ,si dhe për subvencione dhe transfere ishin shpenzuar 39,686€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Vlera e të hyrave të arkëtuara gjatë vitit 2020, ishte më e ultë për 538,138€ në krahasim me vitin paraprak, që rezulton me 23% realizim më të dobët.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	2,499,975	2,499,975	1,766,659	2,304,797	2,001,981
Të hyrat tatimore	977,388	977,388	645,927	775,500	630,507
Të hyrat jo tatimore	1,522,587	1,522,587	1,120,732	1,529,297	1,367,683
Të hyrat tjera	0	0			3,792

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 për komunën ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu komuna kishte përgatitur dy raporte të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 13 rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces, katër rekomandime nuk janë adresuar ende dhe një është i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që azhurnimi i sistemit të tatimit në pronë është bërë me kohë dhe para aplikimit apo procesimit të faturimit të tatimit në pronë. Kjo me qëllim që të sigurohet se faturimi është bazuar në vlerësimin e saktë dhe aplikimin e normave tatimore sipas zonave apo nën zonave të përcaktuara në rregullore.	Sipas testimeve është bërë vlerësimi i saktë i normave tatimore dhe zonave	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që asnjë leje ndërtimore nuk duhet lëshuar	Nuk kemi identifikuar	I zbatuar

		pa marrë të gjitha pëlqimet e nevojshme për fillimin e ndërtimit dhe çdo leje ndërtimore të lëshohet vetëm pasi që është bërë verifikimi i të gjitha dokumenteve për ndërtim.	çështje të ngjashme	
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pronat e shfrytëzuara nga personat privat apo juridik të rikthehen nën kontroll të komunës, ose të bëhet ripërtërija e kontratave në mënyrë që komuna të arkëtojë të hyra nga dhënia në shfrytëzim e pronave.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pagat mëditjet dhe	Kryetari duhet të sigurojë se çdo i punësuar në komunë është i pajisur me kontratë valide konform udhëzimeve, duke përfshirë dhe informacionet për lartësinë e pagës mujore.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar	I zbatuar
6.	Pagat mëditjet dhe	Kryetari duhet të sigurohet se, para fillimit të proceduarve të rekrutimit ka pozita të lira të buxhetuara dhe se janë marrur aprovimet përkatëse nga komuna që kërkohen për miratim të vendimit nga MF, në mënyrë që të siguroj se stafi i angazhuar, nuk do të mbetet jashtë listës së pagave.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar	I zbatuar
7.	Pagat mëditjet dhe	Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. Po ashtu, në rast të punësuarve me marrëveshje dhe shërbime të veçanta të aplikojë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
8.	Mallrat shërbimet dhe	Kryetari duhet të sigurojë që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale janë përcaktuar saktë nevojat që do të realizohen përmes kontratave kornizë, në mënyrë që mos të vie deri te përsëritja e procedurave tenderuese dhe tejkalimit të vlerave të kontratës.	Gjatë testimeve kemi vërejtur se kontratat kornizë nuk e kishin tejkaluar vlerën e kontraktuar.	I zbatuar
9.	Mallrat shërbimet dhe	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e blerjes së mallrave, të caktohen komisionet për pranimin e tyre, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të forcojë kontrollet lidhur me financimin e OJQ-ve dhe të siguroj që plani vjetor për mbështetje financiare dërgohet në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuar.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar


		Njëherit, të forcojë kontrollet në mënyrë që të mbajë përgjegjës përfituesit e mbështetjes financiare dhe raportimi nga ana e tyre të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara.		
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e kapaciteteve të brendshme apo sigurimin e një kontrate për hartimin e projekteve ekzekutive, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit për punë të posedojë projektet e kompletuara.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.	Nuk janë marrë masa.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se organet mbikëqyrëse, menaxherët e kontratave dhe certifikuesi aplikojnë kontrole efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara dhe janë sipas pozicioneve të kontraktuara.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të zotohet që do të marrë të gjitha përgjegjësitë në përputhje me kërkesat e ligjit. Po ashtu duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore, dhe në fund të sigurojë transparencë dhe korrektësi në prezantimin e të gjitha kontratave të nënshkruara.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme	I zbatuar
16.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmer masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje	Nuk ka filluar zbatimin
17.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari, duhet të ndërmer masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe	Llogaritë e arkëtueshme nga zyra	Pjesërisht i zbatuar

		që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.	menaxhimit të mbeturinave dhe drejtoria e kulturës ishin prezantuar saktë.	
18.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.	Komuna ende nuk po arrin të forcojë masat për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Obligimet papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve. Gjithashtu, të sigurojë se obligimet për paga janë prezantuar drejt në PFV.	Ne kemi identifikuar pagesa të cilat nuk ishin kryer me kohë.	Pjesërisht i zbatuar
20.	Auditimi Brendshëm	Kryetari duhet të ndërmerr masat e nevojshme që të sigurojë themelimin dhe funksionimin e KA, i cili duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.	Komuna ka themeluar komitetin e auditimit.	I zbatuar

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pronat e shfrytëzuara nga personat privat apo juridik të rikthehen nën kontroll të komunës, ose të bëhet ripërtëria e kontratave në mënyrë që komuna të arkëtojë të hyra nga dhënia në shfrytëzim e pronave.
4.	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth zbatimit të kontratave, si dhe për progresin në zbatimin e kontratave të raportohet tek kryetari dhe tek zyra e prokurimit në baza të rregullta kohore një apo tre mujore.
5.	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë e ekzekutimit para lidhjes së kontratës, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e obligimeve kontraktuale nga ana e operatorëve ekonomik.
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen në tërësi të gjitha kushtet e vendosura në kontratë, duke aplikuar edhe deklaratën e nënshkruar nga OE për garancionin e punimeve të ekzekutuara/realizuara.

7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.
8.	Çështjet përbashkëta	e Kryetari duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik.
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin e regjistrimit të pasurisë.
10.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.
11.	Llogaritë arkëtueshme	e Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.
12.	Llogaritë arkëtueshme	e Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhen prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë.
13.	Auditimi Brendshëm	i Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Sylaj, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA OF KOSOVO NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Nr. Dokumenti / Doc. No.: 04			
Nr. Dërgimit / Del. No.: 42			
Nr. Prillogjes / Rec. No.: 10/2			
Nr. Përgjigjes / Res. No.: 1			

01-470/05-005249 Z/M
01.07.21



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditimit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit;

Të ndëruar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar dhe raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, të cilin do të përshkruaj afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Z. Agim BAHTIRI

Kryetari i komunës së Mitrovicës Jugore

Data: 30.05.2021.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Ndërtimi i kopshtit Botanika vlera e projektit është 209,575€, Asfaltimi I rrugës në fshatin Cërnushë vlera e projektit është 150,644€ , Asfaltimi I rrugës në Vllahi vlera e projektit është 196,449€, Asfaltimi i rrugës “Pisha” ne fshatin Kqiq vlera e projektit është 99,176€, si dhe Ndërtimi i rrugës në Picel, Lagja Salihu dhe Lagja Syla në fshatin Bajgorë vlera e projektit është 57,342€.

-“ Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse DRU për ngrohje dhe Institucione tjera komunale” – me vlerë 229,950€ “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me vlerë 150,000€, dhe “Furnizime emergjente mjekësore” me vlerë 33,850€, “Furnizimi i shkollave me material Hixheniko Sanitar për Komunë, shkolla dhe Institucione tjera komunale” me vlerë të parshikuar 120,000€, “Ndërtimi dhe rregullimi i fushave të vogla sportive” me vlerë 118,499.94€, “Ndërtimi i objektit shëndetësor- Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Kushtovë “me vlerë 194,331.51€, “Ndërtimi i Labidarit të Martirve “Lagja e Kovaçëve” me vlerë 13.333.33€, si dhe tek procedura “Intervenime emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore” me vlerë 310,000€.

Ndërtimi i kopshtit Botanika vlera e projektit është 209,575€, Asfaltimi I rrugës në fshatin Cërnushë vlera e projektit është 150,644€ , Asfaltimi I rrugës në Vllahi vlera e projektit është 196,449€, Asfaltimi i rrugës “Pisha” ne fshatin Kqiq vlera e projektit është 99,176€, si dhe Ndërtimi i rrugës në Picel, Lagja Salihu dhe Lagja Syla në fshatin Bajgorë vlera e projektit është 57,342€.

Vlera e punëve të kryera sipas situacionit IV-të për kontratën Rregullimi i terreneve sportive dhe nyjave sanitare në SHMFU “Eqrem Qabej”.9. Blerja e aparatit- kamerë në vlerë 1,920€, si dhe blerja e shporetit industrial në vlerë 5,487€.

Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

1 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

11 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.